



**RAPORT PËRMBLEDHËS
JANAR – QERSHOR
2026**

**MBI VEPRIMTARINË
E
QENDRËS SË KOORDINIMIT KUNDËR EKSTREMIZMIT
TË DHUNSHËM
(QKEDH)**

1. HYRJE

Ky raport përmbledh veprimtarinë e Qendrës së Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (QKEDH) gjatë periudhës janar–qershor 2026 dhe rezultatet e arritura në zbatim të VKM-së nr.737/2017, të ndryshuar; VKM-së konfidenciale nr.453, datë 29.07.2021; Strategjisë Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën kundër Terrorizmit 2023–2025; Urdhrit të Kryeministrit nr.185/2023 për Komitetet Rajonale; si dhe akteve të tjera në fuqi.

Me Urdhrin e Kryeministrit nr. 119, datë 19.06.2026, u ngrit Grupi Ndërinstitucional i Punës për hartimin e Strategjisë Kombëtare të Parandalimit të Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftës kundër Terrorizmit 2026–2031 dhe planeve të veprimit 2026–2028. QKEDH përfaqësohet në këtë grup nga Drejtori, në cilësinë e Koordinatorit Kombëtar.

2. FUQIZIMI I INSTITUCIONEVE PUBLIKE DHE KOMUNITETEVE PËR PARANDALIMIN E RADIKALIZMIT DHE EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026, veprimtaria e QKEDH-së u përqendrua në forcimin e koordinimit ndërinstitucional, mekanizmave vendorë të referimit, kapaciteteve të aktorëve të vijës së parë, ndërgjegjësimit komunitar dhe monitorimit të proceseve të rehabilitimit, riintegritimit dhe risocializimit (RRR).

Ndërhyrjet kryesore të realizuara gjatë periudhës raportuese përfshijnë:

- **Fuqizimin e bashkëpunimit ndërinstitucional** në nivel vendor, rajonal dhe ndërkombëtar, duke konsoliduar lidhjet me institucionet ligjzbatuese dhe aktorët e tjerë për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm;
- **Fuqizimin e mekanizmave të referimit** për shkëmbimit të informacionit ndërmjet aktorëve institucionalë dhe strukturave të përfshira, për rritjen e ndërgjegjësimit mbi rreziqet e radikalizmit;
- **Rritjen e kapaciteteve të institucioneve publike** përmes programeve të trajnimit të dedikuara për identifikimin dhe referimin e shenjave të hershme të radikalizmit;
- **Fuqizimin e kapaciteteve për rehabilitim dhe riintegrim** të personave të radikalizuar ose të kthyer nga zonat e konfliktit, duke siguruar mbështetje të specializuar dhe qasje të koordinuar;
- **Mbështetjen ekonomike të familjeve të prekura**, përmes përfshirjes në programe punësimi dhe kurse kualifikimi, me synim reduktimin e faktorëve të riskut social.

Të gjitha këto ndërhyrje janë realizuar në bashkëpunim të ngushtë me institucionet shtetërore përgjegjëse dhe organizatat e shoqërisë civile (OSHC) që veprojnë në fushën e parandalimit dhe kundërshtimit të ekstremizmit të dhunshëm.

Për aktivitetin e Komiteteve Rajonale për Parandalimin e Radikalizmit dhe Luftës kundër EDH

QKEDH monitoron zbatimin e Urdhrit të Kryeministrit nr.185/2023 “Për ngritjen dhe funksionimin e Komiteteve Rajonale për Parandalimin e Radikalizmit dhe Luftës kundër Ekstremizmit të Dhunshëm”. Komiteti Rajonal (KR) është partner dhe autoritet përgjegjës në nivel qarku për zbatimin e mekanizmit kombëtar të referimit të rasteve të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm pranë Koordinatorit Kombëtar për Parandalimin dhe Kundërshtimin e Ekstremizmit të Dhunshëm, funksion ky, që Kryeministri ia ka ngarkuar Koordinatorit Kombëtar / Drejtorit të QKEDH^{sc}.

Ndër përgjegjësitë e Komitetit Rajonal, prioritar është identifikimi dhe referimi pranë QKEDH^{se}, i individëve apo grupeve vulnerabël në rrezik radikalizmi apo të radikalizuar në nivel qarku, nëpërmjet vlerësimit të raportimeve dhe problematikave të diskutuara nga anëtarët e Komitetit Rajonal dhe në bashkëpunim me QKEDH dhe institucionet e tjera, të ndjekë proceset e rehabilitimit, kur identifikohen raste konkrete.

Gjatë periudhës raportuese janë zhvilluar 17 (shtatëmbëdhjetë) takime të Komiteteve Rajonale në qarqet Tiranë, Elbasan, Vlorë, Shkodër, Fier, Berat, Kukës, Korçë, Durrës, Dibër dhe Gjirokastrë. Paralelisht, kanë vijuar raportimet periodike drejtuar Koordinatorit Kombëtar për P/KEDH.

Për qarqe, ku kanë vendbanimin shtetasit e riatdhesuar (*gra dhe fëmijë*) nga zonat e konfliktit në Sirinë Verilindore dhe Irak, Komiteti Rajonal ka shërbyer dhe për ndjekjen e proceseve të ndërhyrjes, rehabilitimit, riintegritit dhe risocializimit, në bashkëpunim me institucionet e tjera, ndër to Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës, që ekzekuton vendimin penal nr.24/2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar në ngarkim të 9 (nëntë) grave të riatdhesuara (*8 dega territoriale Tiranë dhe 1 dega territoriale Elbasan*).

SENSITIVE
SENSITIVE
SENSITIVE
SENSITIVE

Për Këshillat Vendorë të Sigurisë Publike në nivel bashkie

Në zbatim të VKM nr. 678/2024 “Për përbërjen, rregullat më të hollësishme të organizmit dhe funksionimit të Këshillave Vendorë të Sigurisë Publike dhe Këshillit Kombëtar për Sigurinë Publike” me propozim të prefektit të qarkut, janë ngritur Këshillat Vendorë të Sigurisë Publike (KVSP), të cilët kryesohen nga kryetarët e bashkive.

Prej korrikut 2025 zbatohet faza II e programit Global STRIVE, përmes projektit “Mbështetje për përmirësimin e performancës së Këshillave Vendorë të Sigurisë Publike”, i mbështetur nga HEDAYAH përmes Programit STRIVE Global II të Komisionit Evropian dhe i zbatuar nga Instituti për Aktivizëm dhe Ndryshim Social (IANS). Projekti zbatohet në bashkitë Mat, Kukës, Lezhë dhe Vlorë.

Gjatë periudhës raportuese u zhvilluan 5 takime informuese dhe trajnuese në bashkitë Mat, Lezhë, Vlorë dhe Kukës, me pjesëmarrjen e 152 aktorëve vendorë, për prezantimin e “Metodologjisë së Menaxhimit dhe Referimit të Rasteve në parandalimin e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm për KVSP-të”. Gjithashtu, u zhvilluan 23 takime teknike për përgatitjen e planeve vjetore vendorë në 9 bashki: Elbasan, Cërrik, Librazhd, Pogradec, Korçë, Lezhë, Mat, Kukës dhe Vlorë. Gjatë fazës I (2024-2025) projekti i forcimit të KVSP-ve u pilotua në pesë bashki: Elbasan, Librazhd, Cërrik, Pogradec dhe Korçë.

Për trajtimin e fenomenit të EDH në sistemin e ekzekutimit të vendimeve penale

Me mbështetjen e Komisionit Evropian¹, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka integruar në kuadrin rregullator instrumentet dhe programet e specializuara për trajtimin e të burgosurve

¹ Në kuadër të iniciativës rajonale “Rritja e Bashkëpunimit rajonal në Ballkanin Perëndimor për menaxhimin e EDH në burgje dhe parandalimin e radikalizmit të mëtejshëm pas lirimit, që zbatohet në kuadër të fazës së tretë të programit të përbashkët të Bashkimit Evropian (BE) dhe Këshillit të Evropës (KE) “Horizontal Facility III për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë”. Projekti synon menaxhimin e të burgosurve / me synim përmirësimin e

ekstremistë të dhunshëm, duke i institucionalizuar ato si procedura të detyrueshme për zbatim në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale.

Janë ndërmarrë masa për forcimin e procesit të rehabilitimit të burgosurve ekstremistë të dhunshëm dhe individëve të tjerë në rrezik radikalizimi. Është realizuar përshtatja dhe zbatimi i instrumenteve dhe programeve specifike të ndërhyrjes, si dhe hartimi e një programi të posaçëm para-lirimi, me synim mbështetjen e tranzicionit të tyre drejt komunitetit.

Njëkohësisht, po zhvillohet një proces vlerësimi i kuadrit ligjor dhe i mekanizmave të bashkëpunimit ndërinstitucional, me qëllim përmirësimin e mbështetjes para dhe pas lirit të të dënuarve, si dhe forcimin e qëndrueshmërisë së proceseve të rehabilitimit dhe riintegrit afatgjatë.

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës (DPSHP) ekzekuton vendimin penal nr.24/2024 të GJPSHPKKKO në ngarkim të 9 (nëntë) grave të riadhesuara, me të cilin u vendos pezullimi i ekzekutimit të dënimit dhe vendosja e tyre në shërbim prove për një periudhë pesëvjeçare (8 dega territoriale Tiranë dhe 1 dega territoriale Elbasan).

Me mbështetjen e Komisionit Evropian², Shërbimi i Provës ka integruar zyrtarisht në kuadrin e tij normativ dhe rregullator instrumente dhe programe të specializuara për trajtimin e individëve me prirje ekstremiste të dhunshme, duke siguruar zbatimin e tyre të detyrueshëm në proceset e vlerësimit të riskut, mbikëqyrjes dhe rehabilitimit të personave nën mbikëqyrje.

Për forcimin e kapaciteteve profesionale të punonjësve të DPSHP^{së} janë realizuar programe trajnimit të fokusuara për mbikëqyrjen e rasteve, rehabilitimin e individëve me prirje EDH me Plane Individuale Trajtimi, përfshirë gratë e riadhesuara nga zonat e konfliktit.

Po realizohet vlerësimi i nevojave për trajnim të personelit, i cili do të shërbejë si bazë për planifikimin e mëtejshëm të programeve të ngritjes së kapaciteteve dhe përmirësimin e ndërhyrjeve rehabilituese për personat nën mbikëqyrje me rrezik radikalizimi.

Për Planin e Përbashkët të Veprimit “Për Parandalimin dhe Kundërvënien ndaj Terrorizmit dhe Ekstremizmit të Dhunshëm për Ballkanin Perëndimor”

Në janar 2026, Ministria e Punëve të Brendshme, në cilësinë e institucionit lider për hartimin e politikave kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, nisi përgatitjen e Udhërrëfyesit Kombëtar për zbatimin e Planit të Përbashkët të Veprimit për Parandalimin dhe Kundërvënien ndaj Terrorizmit dhe Ekstremizmit të Dhunshëm për Ballkanin Perëndimor (JAP II) në bashkëpunim me ministritë e linjës, agjencitë ligjzbatuese, inteligjente si dhe institucionet e drejtësisë.

Plani i nënshkruar në tetor 2025, ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Ministrave të Punëve të Brendshme të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor, shërben si mjet i integritit gradual në BE. Shqipëria është angazhuar në zbatimin e prioriteteve të përbashkëta rajonale që synojnë harmonizimin e legjislacionit kombëtar me acquis dhe standardet e Bashkimit Evropian, forcimin e masave për parandalimin dhe kundërshtimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, përmirësimin e shkëmbimit të informacionit dhe bashkëpunimit rajonal, luftën

trajtimin dhe rehabilitimin e të burgosurve ekstremistë të dhunshëm (VEPs) brenda institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale.

² Në kuadër të iniciativës rajonale “Rritja e Bashkëpunimit rajonal në Ballkanin Perëndimor për menaxhimin e EDH në burgje dhe parandalimin e radikalizmit të mëtejshëm pas lirit, që zbatohet në kuadër të fazës së tretë të programit të përbashkët të Bashkimit Evropian (BE) dhe Këshillit të Evropës (KE) “Horizontal Facility III për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë”. Projekti synon menaxhimin e të burgosurve / me synim përmirësimin e trajtimin dhe rehabilitimin e të burgosurve ekstremistë të dhunshëm (VEPs) brenda institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale.

kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, si dhe rritjen e mbrojtjes së qytetarëve dhe infrastrukturës kritike, përfshirë përballimin e kërcënimeve kibernetike dhe sfidave që lidhen me përdorimin e teknologjive të reja.

QKEDH ka dhënë e kontributin e saj dhe Udhërrëfyesi është hartuar në linjë me 5 objektivat e JAP II. QKEDH ka kontribuar për masat në zbatim të Objektivit II “Për parandalimin dhe kundërvënien ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm” / *“Effective Prevention and Countering of Violent Extremism (PCVE)”*.

SENSITIVE
SENSITIVE
SENSITIVE
SENSITIVE
SENSITIVE
SENSITIVE

Për Task-Forcën e ngritur për marrjen e masave për riatdhesimin e shtetasve shqiptarë nga zonat e konfliktit

Vijon të jetë efektive Task-Forca (TF) e ngritur me urdhër të Kryeministrit nr.165/2024 “Për ngritjen e Task-Forcës për marrjen e masave për riatdhesimin e shtetasve shqiptarë nga zonat e konfliktit në Siri dhe Irak”. Anëtar i TF është dhe Koordinator i Kombëtar për Parandalimin dhe Kundërshtimin e Ekstremizmit të Dhunshëm (Drejtori i QKEDH-^{se}).

Nën kryesimin e Ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, në gjashtëmujorin e parë të vitit 2026 u zhvillua një takim i Task-Forcës, në të cilin nga ana e QKEDH-^{se} u dha kontribut lidhur me koordinimin e masave fillestare në funksion të rehabilitimit, riintegritit dhe risocializimit në komunitet.

Task-Forca zbaton Procedurat Standarde të Veprimit (PSV) për rehabilitimin dhe riintegritin fillestar të personave të kthyer nga zonat e konfliktit, në linjë me objektivat e Planit të Veprimit. PSV ka për qëllim të ofrojë një kuadër të qartë rregullator që përmban hapat proceduralë për të siguruar një ndërhyrje të specializuar ndërsektoriale dhe multidisiplinore në procesin e rehabilitimit dhe riintegritit të personave të kthyer nga zonat e konfliktit.

Për GTNP që funksionon pranë Agjencisë së Inteligjencës Financiare

Grupi Teknik Ndërinstitucional i Punës (GTNP) është ngritur dhe drejtohet nga Agjencia e Inteligjencës Financiare (AIF) për të rritur efektivitetin e luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në Shqipëri. Gjatë periudhës raportuese (janar – qershor 2026) GTNP është mbledhur dy herë.

QKEDH si anëtar në këtë strukturë, në përputhje me misionin e saj ka rekomanduar marrjen e masave për fuqizim në drejtim të kundërvënies ndaj fenomeneve të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Në linjë me Strategjinë Kombëtare për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit 2024 – 2030, është rekomanduar fuqizimi i kapaciteteve përmes trajnimit në dy fusha: (1) trajtimi i rasteve të riatdhesimit me fokus financimin e terrorizmit dhe (2) menaxhimi i riskut nga fondet e huaja përmes OSHC-^{ve} dhe fondacioneve.

Shqipëria iu nënshtrua raundit të 6^{te} të vlerësimit nga Komiteti MONEYVAL, që u realizua në datat 14-24 prill 2026, nën koordinimin e AIF përgjatë gjithë fazës përgatitore. Në përfundim, AIF komunikon se Shqipëria konsiderohet plotësisht e dalë nga zona gri, që përbën sukses për vendin tonë.

Trajnimi i punonjësve të strukturave ligjzbatuese

Gjatë periudhës janar–qershor 2026, QKEDH ka zhvilluar 13 seanca informuese, në 5 (pesë) Drejtori Vendore të Policisë: Tiranë, Lezhë, Korçë, Kukës dhe Shkodër, me qëllim forcimin e kapaciteteve të rreth 371 punonjësve të Policisë së Shtetit, përfshirë Oficerë të Patrullës së Përgjithshme dhe Specialistë të Sallave të Komandimit. Këto ndërhyrje janë fokusuar në identifikimin e hershëm të shenjave të radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm, llojet e radikalizimit me fokus mbi radikalizimin online, si dhe faktorët që çojnë drejt radikalizimit.

Trajnime për aktorët e vijës së parë

Gjatë kësaj periudhe raportimi, QKEDH ka vijuar bashkëpunimin me organizatat e shoqërisë civile për fuqizimin e kapaciteteve të aktorëve të vijës së parë në adresimin e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Në këtë kuadër, në Gjirokastrë dhe Pogradec janë zhvilluar 5 trajnime dhe sesione informuese, me pjesëmarrjen e 75 profesionistëve, përfshirë punonjës të qendrave komunitare, mësues, oficerë sigurie në shkollë, punonjës të mbrojtjes së fëmijëve, punonjës socialë dhe psikologë. Këto aktivitete synuan rritjen e kapaciteteve për identifikimin e hershëm dhe parandalimin e fenomeneve të radikalizimit, si dhe përdorimin praktik të mekanizmit “Red Button” në faqen e internetit të QKEDH-së (www.cve.gov.al).

Janë organizuar sesione edukimi dhe informimi në 15 njësi administrative në bashkitë Vlorë, Pogradec dhe Fier, me pjesëmarrjen e rreth 290 përfaqësuesve nga strukturat vendore, arsimi, shëndetësia, shoqëria civile dhe komuniteti: rreth 100 në Vlorë, 40 në Pogradec dhe 150 në Fier. Sesionet trajtuan identifikimin e hershëm të shenjave të radikalizimit, bashkëpunimin ndërinstitucional dhe mekanizmat e parandalimit në nivel komunitar.

Bashkëpunime me institucionet akademike

QKEDH, në bashkëpunimit me shoqërinë civile, ka vijuar organizimin e aktiviteteve me institucionet akademike, përkatësisht me Fakultetin e Drejtësisë dhe Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit të Tiranës, duke përfshirë zhvillimin e orëve të hapura me studentët. Këto aktivitete janë fokusuar në identifikimin e kërcënimeve online, njohjen e formave të manipulimit dhe narrativave ekstremiste, promovimin e sjelljes së sigurt në hapësirën digjitale, si dhe nxitjen e raportimit të përmbajtjeve të dëmshme.

Ndërgjegjësimi në sistemin parauniversitar

Gjatë kësaj periudhe janë realizuar gjithsej 21 trajnime, seanca informuese dhe aktivitete të ndryshme ekstrakurrikulare në 15 shkollë, me pjesëmarrjen e 691 nxënësve të sistemit parauniversitar në qytetet Fier, Kavajë, Cërrik, Vlorë, Gjirokastrë dhe Pogradec. Aktivitetet janë fokusuar në promovimin e të drejtave të njeriut dhe tolerancës fetare, duke synuar rritjen e njohurive, zhvillimin e aftësive kritike dhe ndërgjegjësimin e të rinjve për respektimin e diversitetit, nxitjen e bashkëjetesës paqësore dhe forcimin e reziliencës ndaj narrativave polarizuese dhe diskriminuese.

Zbatimi i tyre është mbështetur në një qasje ndërvepruese, krijuese dhe gjithëpërfshirëse, përmes organizimit të ekspozitave me postera dhe piktura, hartimit të eseve dhe poezive, zhvillimit të aktiviteteve sportive, nismave peer-to-peer, intervistave në komunitet, krijimit të mini-bibliotekave në shkollë, si dhe ndërhyrjeve për përmirësimin e mjedisve shkollore.

Nëpërmjet këtyre aktiviteteve është synuar promovimi i të drejtave të njeriut dhe parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm, duke adresuar njëkohësisht fenomene si bullizmi, përjashtimi social dhe diskriminimi, si dhe duke nxitur vlerat e respektit, barazisë, përfshirjes sociale dhe bashkëjetesës paqësore.

Ndërgjegjësimi në komunitet

Gjatë periudhës janar–qershor 2026, organizatat lokale të shoqërisë civile zhvilluan aktivitete dhe forume ndërgjegjëse me të rinj, prindër, mësues, aktorë vendorë dhe përfaqësues të komunitetit. Në Fier u realizuan 5 sesione me rreth 144 pjesëmarrës; në Cërrik një forum komunitar; ndërsa në Vlorë 3 takime në Kaninë, Llakatund dhe Novoselë, me rreth 130 përfitues të drejtpërdrejtë.

Në Tiranë u zhvilluan dy aktivitete me prindër, gazetarë dhe përfaqësues të komunitetit. Një format më i fokusuar përfshiu rreth 15 prindër dhe trajtoi identifikimin e përmbajtjes së dëmshme online, monitorimin e aktivitetit të fëmijëve dhe përdorimin e mekanizmave të raportimit.

Në Pogradec dhe Fier vijoi bashkëpunimi me aktorët lokalë, përfshirë liderë fetarë dhe përfaqësues të tjerë të komunitetit, me gjithsej 32 përfitues. Takimet u fokusuan në komunikimin prind–fëmijë, parandalimin e gjuhës së urrejtjes dhe bullizmit online, sigurinë digjitale dhe komunikimin gjithëpërfshirës.

Fushata ndërgjegjësimi në mediat sociale

Gjatë periudhës raportuese u zhvilluan tri fushata ndërgjegjësimi në mediat sociale, të fokusuara përkatësisht në: (1) promovimin e harmonisë fetare dhe tolerancës; (2) parandalimin e bullizmit dhe gjuhës së urrejtjes, si dhe promovimin e të drejtave të njeriut; dhe (3) identifikimin e kërcënimeve online, raportimin përmes mekanizmit “Red Button” dhe nxitjen e sjelljes së sigurt digjitale. Fushatat iu drejtuan të rinjve, prindërve dhe profesionistëve të vijës së parë dhe u koordinuan me aktivitetet në terren. Përvoja e fushatës u prezantua edhe në një sesion ndërkombëtar online të organizuar nga Hedayah mbi parandalimin dhe kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm.

Në Tiranë u zhvilluan aktivitete ndërgjegjëse dhe outreach me fokus edukimin digjital, tolerancën, kohezionin social, kundër-narrivat ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe mendimin kritik, me pjesëmarrjen e 156 të rinjve dhe studentëve.

Fuqizimi i Komuniteteve Fetare dhe Fushata e Sensibilizimit

Gjatë periudhës 12 mars–23 prill 2026 u zhvillua një fushatë gjithëpërfshirëse me fokus parandalimin e bullizmit dhe forcimin e kohezionit social. Fushata përfshiu komunitetet lokale dhe aktorët fetarë në promovimin e respektit, solidaritetit, tolerancës dhe bashkëjetesës.

Fushata u zbatua përmes një qasjeje shumëkanalëshe dhe ndërsektoriale, duke ndërthurur komunikimin institucional, median tradicionale, platformat digjitale dhe aktivitetet në komunitet. Shtrirja e vlerësuar ishte rreth 550,000–560,000 persona në nivel kombëtar, pas përlllogaritjes së mbivendosjes së audiencave.

Në aspektin e fuqizimit të komuniteteve fetare, fushata kontribuo në:

- rritjen e ndërgjegjësimit mbi rolin e tyre si struktura me ndikim të lartë në nivel komunitar;
- përforcimin e mesazheve të përgjegjësisë morale dhe sociale për mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve;
- krijimin e një narrative publike që promovon tolerancën, dialogun dhe ndërhyrjen e hershme ndaj sjelljeve të dhunshme apo diskriminuese.

Përfshirja e kanaleve lokale të komunikimit, përfshirë ato me bazë fetare, mundësoi arritjen e audiencave me akses më të kufizuar në komunikimin digjital dhe përforcoi mesazhet për

mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve, dialogun dhe ndërhyrjen e hershme ndaj sjelljeve të dhunshme ose diskriminuese.

Fushata kontribuoi në rritjen e ndërgjegjësimit publik dhe në përforcimin e narrativës kundër bullizmit, duke krijuar bazë për vijimin e ndërhyrjeve parandaluese me aktorët fetarë, arsimorë dhe komunitarë.

3. PROCESI I REHABILITIMIT/RIINTEGRIMIT/RISOCIALIZIMIT PËR PERSONAT E KTHYER NGA ZONAT E KONFLIKTIT SIRI/IRAK

QKEDH si institucioni kryesor për zhvillimin e politikave dhe koordinimin në nivel kombëtar, në kuadër të realizimit të iniciativave për parandalimin dhe kundërshtimin e ekstremizmit të dhunshëm, si dhe ndjekjen e proceseve të rehabilitim-riintegrim dhe risocializimit të të kthyerve nga zonat e konfliktit Siri-Irak, vepron në bazë të VKM (konfidenciale) Nr. 453 datë 29.07 2021 si dhe Strategjisë Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën Kundër Terrorizmit 2023 – 2025 si më poshtë:

Shteti shqiptar ka kryer 4 operacione riatdhesimi, ku ka kthyer 38 (tridhjetë e tetë) shtetas shqiptarë nga zonat e konfliktit Siri-Irak, *konkretisht 1(një) shtetas në vitin 2019 (i cili nuk ndiqet nga QKEDH), 13 (trembëdhjetë) shtetas shqiptarë që u riatdhesuan më datë 27 maj 2022, 19 (nëntëmbëdhjetë) shtetas shqiptarë të riatdhesuar më datën 1 gusht 2021 dhe 5 (pesë) shtetas të riatdhesuar në 27 tetor 2020. Gjithashtu më 14 Shkurt 2026 është realizuar një kthim vullnetar në territorin e Republikës së Shqipërisë në kuadër të operacioneve të koordinuara të riatdhesimit.*

Procesi i rehabilitimit, riintegrimit dhe risocializimit (RRR) të shtetasve të riatdhesuar është një komponent i rëndësishëm i sigurisë kombëtare, mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe kohezionit social. Qasja parandaluese synon uljen e riskut të riradikalizimit dhe përjashtimit social përmes ndërhyrjeve të koordinuara institucionale.

QKEDH koordinon dhe monitoron procesin RRR për 38 shtetas të riatdhesuar që ndiqen aktualisht me plane individuale; shtetasi i riatdhesuar në vitin 2019 nuk ndiqet nga QKEDH.

SENSITIVE
SENSITIVE

QKEDH ndjek dhe monitoron procesin e RRR në nivel qendror dhe vendor duke u fokusuar në zbatimin e PIM³ zhvilluar për secilin person nga PMF⁴ për fëmijët dhe PS⁵ / menaxheri rastit i Njësi Administrative ku janë vendosur familjet me banim. Në përmbushje të këtij funksioni, QKEDH është pjesë e të gjitha takimeve të GTN ku vlerësohet PIM për secilin rast dhe koordinohet e ndiqet në një linjë me PMF-të.

QKEDH ndjek 38 plane individuale, të cilat rishqyrtohen çdo tre muaj nga grupet teknike ndërsektoriale. Gjatë periudhës raportuese u zhvilluan 15 takime të këtyre grupeve për 12 familjet e rikthyera. Grupi përfshin 19 të mitur, 9 të rinj që kanë mbushur moshën 18 vjeç dhe 9 gra të ndjekura nga Shërbimi i Provës.

Në lidhje me arsimin, 19 të mitur ndjekin arsimin bazë të detyrueshëm.

SENSITIVE
SENSITIVE

Deri në muajin dhjetor 2025, nevojat bazike të familjeve të riatdhesuara nga zonat e konfliktit Siri-Irak janë mbuluar në mënyrë të vazhdueshme përmes mbështetjes së ofruar nga donatorët

³ Planeve Individuale të Mbrojtjes

⁴ Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijës

⁵ Punonjësi Social

dhe organizatat e shoqërisë civile, duke përfshirë shpërndarjen periodike të kartave ushqimore, mbulimin e kostove të strehimit me qira, si dhe rimbursimin e shërbimeve bazë jetike (energji elektrike dhe ujë). Kjo mbështetje ka pasur karakter të përkohshëm dhe plotësues, në funksion të fazës tranzitore të procesit të rehabilitimit, ri-integrimit dhe risocializimit.

SENSITIVE
SENSITIVE
SENSITIVE
SENSITIVE
SENSITIVE
SENSITIVE
SENSITIVE

Të ndodhur në kushte të strehimit emergjent për dy familje pranë ambjenteve të Drejtorisë së Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale / Bashkia Tiranë u realizua takimi me përfaqësues nga QKEDH, Shërbimi i Provës, Bashkia Tiranë dhe AKPA nga ku u diskutuan alternativat për strehim. Sa më sipër dhe në zbatim të VKM (konfidenciale) Nr.453, datë 29.07.2021 “Për disa ndryshime në vendimin Nr.826, datë 26.10.2020 të Këshillit të Ministrave “Për Ofrimin e Shërbimeve për Pritjen dhe akomodimin e fëmijëve të pashoqëruar të kthyer nga Siria dhe Iraku” u drejtua kërkesë Këshillit Bashkiak për trajtimin me prioritet dhe procedura përjashtuese të dosjes së aplikimit për bonus qiraje. Në mbledhjen e Këshillit Bashkiak të datës 11.05.2026 u miratua vendimi për trajtimin me proces përjashtimor të rastit për përfitimin e bonusit të qirasë. Me vendim të këshillit bashkiak Nr.42, datë 12.05.2026 u miratua vendimi për trajtimin me subvencionin e qirasë për dy familje me qera mujore baziqe.

SENSITIVE
SENSITIVE

Nevojitet kalimi nga mbështetja e përkohshme e projekteve drejt një angazhimi të qëndrueshëm institucional dhe financiar për strehimin, shërbimet bazë, punësimin dhe mbështetjen psikosociale.

4. QKEDH si Pikë Fokale për Projektin Evropian me CIVIPOL

QKEDH vijon të ushtrojë rolin e saj si pikë fokale për projektin e ri evropian “Përmirësimi i qëndrueshmërisë së entiteteve kritike dhe mbrojtja e hapësirave publike dhe hapësirës kibernetike ndaj kërcënimeve të sigurisë në Ballkanin Perëndimor” (WB CEPS & Cyber), i cili përfaqëson fazën pasuese të projektit të përfunduar në vitin 2026 “Rritja e mbrojtjes së hapësirave publike dhe infrastrukturave kritike në Ballkanin Perëndimor”, të zbatuar nga CIVIPOL. Në këtë kuadër, QKEDH ka koordinuar pjesëmarrjen me MPB dhe DPPSH në:

- Aktivitetin e prezantimit të projektit të ri trevjeçar të WB CEPS & Cyber ku u prezantua puna e Qendrës së Kapaciteteve Kibernetike për Ballkanin Perëndimor.
- Forumin Rajonal, i cili u pasua nga takimet hapëse të tre grupeve teknike të punës, konkretisht: Grupi i Punës për Mbrojtjen e Hapësirave Publike (PS WG); Grupi i Punës për Mbrojtjen dhe Qëndrueshmërinë e Entiteteve Kritike (CE WG); si dhe Grupi i Punës për Partneritetet Publik-Privat (PPP WG).



Qendra e Koordinimit
KUNDËR EKSTREMIZMIT
TË DHUNSHËM
- Shqipëri


KOMITETET RAJONALE

PËR PARANDALIMIN E RADIKALIZMIT DHE LUFTËN
KUNDËR EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM

JANAR – QERSHOR 2026

SHTRIRJA TERRITORIALE

Takime të zhvilluara në të gjitha qarqet e vendit



12 qarqe të përfshira • pikat blu paraqesin numrin e takimeve për qark

MBULIM KOMBËTAR

12 QARQE

17 takime gjatë gjashtëmujorit

QARQET E PËRFSHIRA

- 1 Berat
- 2 Dibër
- 3 Durrës
- 4 Elbasan
- 5 Fier
- 6 Gjirokastrë
- 7 Korçë
- 8 Kukës
- 9 Lezhë
- 10 Shkodër
- 11 Tiranë
- 12 Vlorë

17 takime të Komiteteve Rajonale • 12 qarqe

Harta e bazës: SimpleMaps.com • Përpunim grafik: QKEDH

QKEDH



Qendra e Koordinimit
KUNDËR EKSTREMIZMIT
TË DHUNSHËM
- Shqipëri

REZULTATET KRYESORE

VEPRIMTARIA E QKEDH-SË

JANAR – QERSHOR 2026

NË NJË VËSHTRIM

17

TAKIME

Komitetet Rajonale në 12 qarqe

371

PUNONJËS POLICIE

13 seanca informuese në 5 DVP

691

NXËNËS

21 aktivitete në 15 shkolla

550-560

MIJË PERSONA

Shtirja e vlerësuar e fushatës

AKTIVITETET DHE MEKANIZMAT KRYESORË

GTN

PROGRAMET E REHABILITIMIT, RIINTEGRIMIT DHE RISOCIALIZIMIT

15 takime • 12 familje

Monitorim periodik përmes Grupeve Teknike Ndërsektoriale

KVSP

NGRITJA E KAPACITETEVE

5 takime/trajnime • 152 aktorë

Aktivitetet në 4 bashki

PLAN

PLANET VENDORE

23 takime teknike

Mbeshtetje për planet vjetore të 9 bashkive

AVP

AKTORËT E VIJËS SË PARË

5 trajnime • 75 profesionistë

Gjirokastrë dhe Pogradec

DIGJITALE

NDËRGJEGJËSIMI DHE MEDIAT SOCIALE

3 FUSHATA

Harmonia fetare • Bullizmi dhe gjuha e urrejtjes • "Red Button"

Grupet e synuara: të rinj, prinder dhe profesionistë të vijës së parë

SHËNIM METODOLOGJIK

Të dhënat e pjesëmarrjes paraqiten sipas kategorive të raportuara dhe nuk agregohen në një total të vetëm, për shkak të mundësisë së mbivendosjes ndërmjet grupeve. Shtirja 550-560 mijë është vlerësim i audiencës së fushatës shumëkanalese.

Qendra e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm

QKEDH

5. SFIDA DHE REKOMANDIME

REDAKTUAR



Drejtor

Lejdi DERVISHI